

VENDIM
Nr.32, datë 31.3.2011

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “GSA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3, neni 16 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “GSA” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Bazuar në vendimin nr.79, datë 21.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. “Për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike”, licenca e subjektit “GSA” sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ka përfunduar që në datën 26.1.2011 dhe aktualisht subjekti nuk ka licencë.

- Kërkesa për rinovimin e licencës së këtij subjekti është paraqitur në ERE, në datën 17.3.2011, pra në mosrespektim të afatit të paraqitjes së kërkesës për rinovim të licencës sipas nenit 16 pika 1, në të cilin përcaktohet se: “Jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.”

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
NË DETYRË
Entela Shehaj